

NË KËRKIM TË GJYSHIT

Nga Përparim Vasolli

Më kujtohet kur kam filluar të bëjë pyetjet, “Pse nuk kam gjyshër si gjithë të tjerët? Ku është trangu familjar?” Babai gjithmonë më ka dhënë përgjigje të turbullta derisa nuk mund të fshihte më të vërtetën. “Ata janë vrarë,” tha ai. “Nga kush?” pyeta unë. Për një kohë të gjatë ai përsëriste, “Nuk e di”. Më vonë, kuptova që kishin qenë çetnikët.

Gjyshi nga ana e babait, Qërim Vasolli, lindi në vitin 1912 në Orllan, ku tani është Liqeni i Batllavës, përveç se atëhere nuk ka pas liqe, vetëm tokë të plleshme që Vasollët e kanë punuar. Me 1941, në atë pjesë erdhën çetnikët dhe vranë pesë vëllezërit e Qërimit. Vetëm ai dhe një vëlla i vogël i shpëtuan masakrës dhe erdhën në Prishtinë. Babai im Ragipi ishte pesë vjeç kur Qërimi u zhduk. Nëna e tij Sherifja vdiç katër vite më vonë, prandaj nuk dijmë shumë për familjen e babait.

Në vitin 1943 babai i nënës Ram Berisha u vra me vëllanë Bajramin në Svircën e Poshtme, një fshat afër Gjilanit në kufirin lindor me Serbinë. Çetnikët i lidhën në një dru, së pari i prenë gjymtyrët, mandej kokët. Bashkëshortja Halimja ishte shtatzënë me nënën time, e cila ishte një grua shumë e bukur, prandaj edhe mori emrin Bukurijs. Halimja u largua me të tërë fëmijët për të gjetë mbrojtje te shtëpia e vëllaut Zuk Leci në Gmicë. Gjatë atyre ditëve nuk mund të gjeje mbrojtje nga OKB, OSBE, apo KFOR. Në atë zonë, Zuk-a një burrë i fortë, ishte OKB. Bukurijsa nuk mban në mend se çfarë i ka ndodhë të atit, por ne dijmë diçka mbi vrasjen e tij meqë biri i tij më i rrituri Shapi, ishte 16 në atë kohë.

Nuk kemi asgjë prej Qërimit përveç fotografisë me madhësi të letërnjoftimit që e mbaj në iPhone. Rukija, gruaja që u martua me vëllaun e tij dhe u kujdes për babain tim kur mbeti jetim, ma dha mua në vitin 2001. Fëmijët e Rukijes gjithmonë i kam thirrë axhë e halla, ndërsa fëmijët e tyre kushërinjë. Gjatë rritjes ata ishin familja e vetme që njihja. Ata ishin familja e vetme që babai njihje.

Gjatë një kohe, pas masakrës së vëllezërve, Qërimi vizitoi familjen e tij në Prishtinë por vetëm gjatë natës. Ai asnjëherë nuk flejti në shtëpi. A po fshihej në male? Nga kush? A ishte duke luftuar? Pasi humbi pesë vëllezërit ai iku. E dinim që ishte arrestuar gjatë viteve 1946-47 dhe ishte dërguar në burgun e Pozharevacit, nga i cili u arratis së bashku me një shok. Shoku i tij nuk i'a doli të ikte. Ishte dimri i vitit 1947-48.

Qërimi u pa në vitin 1948 nga dikush i Prishtinës që ishte ushtar i Titos i pozicionuar në kufi të Italisë. Ajo ishte koha kur kishte tension të madh në mes Jugosllavisë e Italisë dhe trupat rrinin në gatishmëri në të dy anët e kufirit. Edhe pse kishte veshur uniformën e oficerit italian, ky ushtar e njohu Qërimin. Ai tha, “Harroje, të gjithë në familjen tënde është vrarë, nuk e ke askënd gjallë.” Dua të besoj se kjo është arsyeja pse ai nuk u kthye më kurrë.

Babai im provoi, në mënyrën e tij, të gjente Qërimin. Kur u rrit, filloi kërkimin e kushërinjëve në Orllan. Njerëzit e mbanin në mend masakrën, por shumë ishin larguar për në Turqi gjatë migrimeve të mëdha të viteve 1950-ta. Babai im shkoi në Turqi dhe e gjeti një kushëri jo të afërt, që i tregoi gjithëçka që dinte. Jo shumë.

Në vitin 1968 babai im kontaktoi Radio Romën, që kishte një program për njerëzit e humbur. Ishte e vështirë të komunikoje atëherë, nuk kishte telefon, kishim telefonin e parë në vitin 1974. As nuk e di se si e ka kontaktuar Radion, ndoshta përmes postës, telegrafit apo radios. I thanë që po, në të vërtetë ishte një

Qërim Vasolli që po luftonte në Qipro si mercenar. Ai po mungonte në aksion. Do të duhej të kishte pasur një jetë interesante. Çfarë ka bërë në Qipro? A ka mbijetuar? Ndoshta si mercenar, ai arriti të një pikë ku mendoi të 'a mbathte për të shpëtuar jetën e vetë.

Vëllau im i vogël që është i zoti me kompjuterë, gjeti një program me të cilin mund të gjesh të gjithë njerëzit në botë që kanë mbiemrin e njejtë. Gjetëm shumë Vasolli në Argjentinë me emra si Iliriana dhe Adriana. Menduam se kemi një mundësi të mirë për të gjetur të afërmit meqë Vasolli është një mbiemër më i rrallë edhe ktu. I kontaktova këta njerëz. E thirra një vajzë që tha, "Po, mbiemri im është Vasolli por nuk kam të bëjë asgjë me Kosovë." Po ashtu e thirra një Vasolli në Boston, por gruaja e cila e ngriti telefonin ishte më e moshuar dhe më bërtiti, "Më lër të qetë." Ndoshta mendoi që po kërkoj të holla nga ajo.

Ne dijmë vetëm edhe një tregim për gjyshin tonë, që lidhet me familjen e nënës. Kur babai takoi nënën dhe i propozoi asaj, ata është dashtë të flisnin me xhaxhain e saj Zuk Lecin për të kërkuar leje. Zuk-a ishte sa një mal me mustaqe të gjata. Ishte burri më i fuqishëm në atë zonë, gjithmonë e thirrnin për ndërmjetësim të gjakmarrjes. Kur ai fliste, duhej t'i përcjellje urdhërat e tij. I vetmi djalë në familjen e nëntë motrave, ai ishte dymbëdhjetë kur vriste xhandarët serbë – atëhere ishte Mbretëria Jugosllave - që i kishte vrarë babain. Atij i është dashtë të shkojë në male për t'i ikur kapjes, por pas disa viteve e zënë rob dhe e dërgojnë në burg.

Gjyshja i'u afrua për kërkesën e Ragipit për të martuar Bukurinë. Ai pyeti, "Si është emri i babait të tij?" Ajo tha, "Qërim". Zuk-a e dha pëlqimin e tij pa hezitim. "Po, sigurisht, ai ishte në burg me vëllaun e tij, më kujtohet, e linte vëllaun të flinte mbi të," ai tha. Atëhere të burgosurit flinin në dysHEME të cementit, dhe Qërimi në atë mënyrë e mbronte vëllaun e vogël.

Këto i kishim dëgjuar prej Zuk-ës. Nuk di asgjë tjetër për gjyshin Qërim, por asnjëherë nuk ndalova së kërkuari për të. Bile, një herë vendosa fotografinë e tij si foto profili në Facebook. Kushedi, mendova, ndoshta dikush e njeh.

Dija më shumë për gjyshin nga ana e nënës, të paktën e dija se ishte vrarë. Gjithashtu, paraprakisht kam pasur informatë se ku është varrosur. Pas luftës, dhe pasi zura vend dhe pata kohë për të zhvilluar hulumtimin, shkova në Svirçë.

E dija se një burrë nga një fshat i afërt kishte marrë trupat e masakruar të dy vëllezërve Berisha dhe i kishte varrosur diku tjetër. Ashkush nuk e dinte se ku. U mundova t'a gjeja atë njeri, por në vend të tij gjeta Naim Veligllavën. Naimi është i ri dhe jeton me gruan e dy fëmijët e tij në një fshat, që quhet Veligllava. Natyra është shumë e bukur, aty nuk jeton askush, vetëm Naimi me familjen e tij. Shtëpia e tij ishte e vetmja ku shihja dritat kur po shkoja lart në male. I tregova për gjyshin dhe premtoi se do të ndihmonte.

Pas një jave më thirri. Kishte gjetur dikë që dinte për varrezën e Berishëve. Mora me vete dajën Shaip, tash i moshuar. E gjetëm një varr të rrethuar nga dy gurë. E pastrova pak, mirëpo nuk preka asgjë. U ktheva prapa dhe kontaktova policinë, kryetarin e fshatit, xhaminë, madje edhe KFOR-in për të më lejuar t'a çgroposja.

Shaipi mbante në mend se babai po hiqte lëvorën e mollëve me një thikë kur çetnikët e morën. Ai e

mbante në mend se si ishte veshur. E gjetëm thikën, ishte si e re, vetëm mbajtësja ishte pak e ndryshkur, si dhe pullat që gjyshi i kishte veshur. Kisha studiuar mjeksinë dhe e dija se mënyra se si eshtërat ishin rradhitur në varr, konfirmonin historinë e vrasjes. I rivarrosëm në Prishtinë. Pullat e Ram-it ju dhashë fëmijëve të tij.

Pse ishin vararë? Ndoshta sepse ishin bujq të zotë, kishin shumë kafshë, qumësht, bukë, dhe ishin të fortë. U vranë sepse nëse më të fortët vriteshin, atëherë të gjithë do të iknin, gjë që e bënë. Këto vrasje patën një qëllim. Të gjithë ato fshatëra afër kufirit, janë bosh. Kur nuk ka njerëz, kufijtë nuk janë të sigurtë.

Babai im ishte i lumtur kur e gjeta të atin e nënës, por ishte i zhgënjyer që nuk kishte asgjë prej babait të vetë. Gjithë jetën kishte qenë jetim. Gjyshi kishte mundur të rrinte në shtëpi me familjen e tij, por mori vendimin që të ikte. Ndoshta donte të mirrte hak për vëllezërit. Ndoshta dikush është lënduar nga ai, dhe mund të jetë ndonjë familje emrin e të cilës asnjëherë nuk e kemi dëgjuar. Kur atëhere mirret vendimi, jeta të dërgon herë andej e herë këndej.